



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 26 Dt. 13.02.2017

“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI  
ELEKTRIKE”- SUBJEKTIT “FATJON& RRUGA –URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN”  
SH.P.K

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pika 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”,të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni” , për paisjen me autorizim të subjektit “ **FATJON&RRUGA –URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN** ” sh.p.k , me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe opionencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**FATJON&RRUGA –URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN**” sh.p.k me administrator **Z.Bashkim GJOKA** , për përdorim të burimit ujqor Përroi Buzëmardhes , degë e Lumit te Bushtricës , për prodhim energjie elektrike në Buzëmardhe ,Njësia Administrative Gryke-Çaje ,Bashkia Kukës , Qarku Kukës . Sipas studimit të paraqitur nga subjekti , **HEC KULOTA** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes : X – 44 56 249 ; Y – 46 44 392 ; Z – + 1335 m

Koordinatat e godinës së centralit: X – 44 55 286 ; Y – 46 42 952 ; Z – + 1120 m

Koordinatat e pikes së shkarkimit : X – 44 55 286 ; Y – 46 42 952 ; Z – +1120 m

Prurja mesatare e përroit:  $Q_{mes} = 0.42 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti:  $Q_{llog} = 0.85 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;

Prurja ekologjike:  $Q_{ekol} = 0.15 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;

Prurja që shkarkohet:  $Q = 0.85 \text{ m}^3/\text{sek}$ .

2- Autorizimi i përdorimit të burimit ujqor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETARI  
Martin PLLUMBI



KRYETARI  
Paulin RADOVANI

